

Elbasan më: \_\_\_\_/ \_\_\_\_/ 2024

## PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNË

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

#### **OBJEKTI I PROKURIMIT:**

**“Rikonstruksioni plotë i ujësjellësave të fshatrave Kotorr dhe Stror si dhe ndërtim i ujësjellësit të ri, Liras, Njësia Administrative Pishaj, Bashika Gramsh”.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punimet për ndërtime të plota ose të pjesshme: **Punime ndërtimi për ujësjellës 45247130-0**

#### **VLERA E FONDIT LIMIT:**

**102 279 863** (njëqind e dy milionë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) Lekë, **pa TVSH**

**122 735 835, 6** (njëqind e njëzet e dy milionë e shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë presje gjashtë) **me TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan” sha**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, mbështetur në projektin dhe preventivin e miratuar, me vendimin nr. 12, dt. 04. 04. 2024, me nr. 1042/3 prot., me përmbajtjen si më poshtë:

#### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

##### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

##### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

##### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

###### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

---

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

**Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe në nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore për vitet financiare **2021, 2022, 2023**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël **se vlera e fondit limit që prokurohet.**

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në nenin 43 dhe të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në pikën 1, të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar: “1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”, gjithashtu, bazuar dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, në Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në VKM nr. 922 datë 29. 12. 2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

**2.2.2** Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, e ligjit nr. 10091 date 5. 3. 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabël.

*Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.*

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, mbi bazën e të cilave, autoriteti kontraktor mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi “të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 5, datë 30. 01. 2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligjin nr. 9920 datë 19. 05. 2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, me anë të dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, pranë Njësive Vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.*

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe në Ligjin nr. 9632, datë 30. 10. 2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19. 05. 2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe nenin 40 në Ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në Ligjin nr. 9723 datë 03. 05. 2007 “Për QKR” i ndryshuar.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

### **2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

## **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

**Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentet e mëposhtme:**

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
1. Kontratën e Sipërmarrjes,
  2. Situacionin përfundimtar të objektit
  3. Aktin e Kolaudimit të objektit
  4. Certifikatën e marrjes në dorëzim të objektit
  5. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës
  6. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Kontratën e Sipërmarrjes,
  2. Situacionin përfundimtar të objektit
  3. Aktin e Kolaudimit të objektit
  4. Certifikatën e marrjes në dorëzim të objektit
  5. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës

Pika 2.3.1 germa “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Pika 2.3.1 germa “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-së nr. 285 datë 19 .05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar).

### **Argumentimi:**

Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

1. Për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
2. Për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

## Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Gjithashtu referuar VKM-së nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

Autoriteti Kontraktor argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentet e kërkuara sipas pikave që vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM-së Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

### **2.3.2 Licensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.**

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se disponon licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë

duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16. 01. 2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licencat e mëposhtme:**
  - **N.P-1** (Punime gjurmimi e toke) **Niveli A**
  - **N.P-4** (Rrugë, autostrada, mbikalime,) **Niveli A**
  - **N.P-5** (Punime nëntokësore, ura vepra,) **Niveli A**
  - **N.P-7** (Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa,) **Niveli D**
  - **N.P-9** (Punime dhe mbrojtje lumore,) **Niveli B**
  - **N.P-12** (Punime të inxhinierisë së mjedisit) **Niveli B**
  
- **Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licencat e mëposhtme:**
  - **N.S.-14** (Impiante te brendshme, elektrik,) **Niveli A**
  - **N.S.-18** (Punime topogjeodezike,) **Niveli C**
  - **N.S.-20** (Shpime gjeologo-inxhinier,) **Niveli A**

Operatorët ekonomikë duhet të kenë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë ata duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16. 01 .2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për dhënien e licensave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimore”.

Operatorët e huaj duhet të barazvlerësojnë (ekuivalentojnë) licencat profesionale që ata kanë lëshuar nga vendi i origjinës, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrinë kompetente) në Republikën e Shqipërisë. (Rregullore për kriteret dhe procedurat për lëshimin e licensave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, miratuar nga VKM, Nr. 42, datë 16.01.2008).

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16. 01. 2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Referuar kategorive të kërkuara, autoriteti kontraktor argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë e vendosura sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për çdo zë pune, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16. 1. 2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të

zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gërmimi në tokë	Sipas zërave të preventivit	A	0-20 milion lekë
NP-4	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.	Sipas zërave të preventivit	A	0-20 milion lekë
NP-5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti.	Sipas zërave të preventivit	A	0-20 milion lekë
NP-7	Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje.	Sipas zërave të preventivit	D	101-200 milion lekë
NP-9	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.	Sipas zërave të preventivit	B	20-50 milion lekë
NP-12	Punime të Inxhienerisë mjedisore	Sipas zërave të preventivit	B	20-50 milion lekë
NS-14	Impiante të brendshme, elektrik	Sipas zërave të preventivit	A	0-20 milion lekë
NS-18	Punime topogjeodezike.	Sipas zërave të preventivit	C	50-100 milion lekë
NS-20	Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.	Sipas zërave të preventivit	A	0-20 milion lekë

**2.3.3.** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, *ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm si dhe të ketë eksperiencë pune minimum 10 (dhjetë) vjet.

- i. Librezë pune (përkatëse)
- ii. C.V (përkatëse)
- iii. Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- iv. Diplomë

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

#### **Argumentimi:**

Kërkesa është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në nenin 39, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, dhe në bazuar në Kreun I/2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13. 05. 2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, ku përcaktohet se “Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventivuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.

#### **2.3.4 Staf kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për këto punime:**

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:

- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi (Profili Struktura)**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Elektrik**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Mjedesi**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Mekanik**
- Minimuni 2 (dy) **Inxhinier Hidroteknik**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Gjeolog (Hidrogjeolog)**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin sipas kërkesave të mëposhtme:

- Stafit teknik i sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listë-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten:
  - Diploma,
  - Kontratë individuale pune (e vlefshme),
  - Librezë pune,
  - C.V. dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**2.3.4.1.** Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder**
  - Minimuni 1 (një) **Inxhinier Hidroteknik**
  - Minimuni 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi**
-



*\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës përkatëse në DST, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

*Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë:*

- *Kontratë pune të vlefshme,*
- *Diplomë,*
- *Librezë pune*
- *C.V.*

### **Argumentimi:**

Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik, mjedisi, mekanik, hidroteknik, topograf/marksheider, gjeolog, etj., është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të pasur rezultatin e kërkuar në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol specifik në mbarëvajtjen e punimeve, pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij gjithashtu këta drejtues teknik plotësojnë kërkesat e fushave të zbatimit sipas profilit përkatës.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të natyrës së punimeve që i është bërë projektit të zbatimit të Punimeve (ku përcaktohet dhe profili inxhinierik), si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2, kapaciteti teknik në DST.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve, rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.3.4., dhe 2.3.4.1. të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin, stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

### **Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të projektit të zbatimit punimeve.**

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit në proceset e punës. Ky inxhinier ka për detyrë menaxhimin e zbatimit të punimeve ndërtimore, analizimin e projektit pasi kemi të bëjmë me punime ndërtimi apo rikonstruksioni, ndjekjen e ecurisë së punimeve në kantier gjithashtu plotësimin e dokumentacionit përkatës për dosjen e zbatimit;
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve, referuar preventivit të instalimeve elektrike si dhe në proceset e punës gjithashtu plotësimin e dokumentacionit përkatës për dosjen e zbatimit.

- **Inxhinieri i Mjedisit** është përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjitha punimeve dhe sigurimin që punimet e kryera, të mos cenojnë kushtet dhe parametrat mjedisore të terrenit, dhe të kenë ndikim sa më të vogël në mjedis.
- **Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve, referuar projektit të zbatimit si dhe ndjekjen e anës teknike të makineri pajisje në objekt.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve, referuar zërave hidroteknike dhe instalimeve”, etj. Ky inxhinier është përgjegjës për shtrimin e linjave të ujësjellësit, vendosjen e matësve të ujit të pijshëm, rakorderive, etj., ku është e nevojshme që punimet të zbatohen dhe kontrollohen në mënyrë konkrete nga ana e inxhinierit me profilin e duhur gjithashtu plotësimin e dokumentacionit përkatës për dosjen e zbatimit;
- **Inxhinieri Gjeodet/ Topograf/ Markshajder** është përgjegjës për kryerjen e azhornimit topografik dhe piktimitin e objektit , si dhe do të ndjekë punimet e zbatimit sipas kuotave të projektit. Gjithashtu pas përfundimit të punimeve do të bëjë edhe azhornimin faktit . Ky inxhinier është i nevojshëm për dhënien dhe vendosjen në terren të kuotave të nevojshme mbi dhe nën tokësore, gjatë zbatimit të punimeve të objektit deri në përfundimin e plotë të tij në përputhje me kuotat e përcaktuara në projektin e zbatimit të objektit gjithashtu plotësimin e dokumentacionit përkatës për dosjen e zbatimit.
- **Inxhinieri Gjeolog** është përgjegjës për punimet e verifikimeve të tabanit/tabaneve në të cilët do të ndërtohen strukturat, apo do të ketë shpime me qëllim realizimi e punimeve , si dhe mbarëvajtjen e tyre sipas Kushteve Teknike dhe kontrollin e gjeologjisë nëse është apo jo e përshtatshme për kryerjen e këtyre punimeve.

### 2.3.5 Staf i Ndhmës/Mbështetës/Certifikimet ose Kualifikimet mbështetëse:

- a) **1 (një)** person, pjesë e stafit të shoqërisë, i certifikuar si *Ekspert Zjarrfikës* në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin,

(Për ekspertin zjarrfikës certifikata e ekspertit zjarrfikës si dhe Kontrata e punës (e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të ndërtimit, si dhe të rezultojë në listë-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit).

#### Argumentimi:

Në lidhje me kërkesën për disponimin e 1 (një) specialisti *Ekspert Zjarrfikës* në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, njësia e prokurimit vlerëson se, kjo kërkesë është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi stafi operacional i operatorit ekonomik duhet të jetë i trajnuar për çdo rast emergjence, ku ndër to janë edhe rastet e zjarrit, kërkesë kjo bazuar në parashikimet e nenit 38 të Ligjit Nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, në të cilin përcaktohet se, **personat fizikë dhe juridikë zbatojnë dispozitat e parashikuara nga ky ligj dhe akte të tjera nënligjore, në lidhje me marrjen e masave për parandalimin e pakësimit e zjarreve, me anë të mjeteve, sistemeve, pajisjeve të diktimit-sinjalizimit për shuarjen e zjarreve, gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre.**

b) **1 (një)** person, pjesë e stafit të shoqërisë, të pajisur me certifikatën e Trajnimit për “*Përgjegjës për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë sipas ISO 9001:2015*”, (ose ekuivalente) e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.

(Për përgjegjësën e kontrollit të cilësisë duhet të paraqitet Certifikata përkatëse si dhe Kontrata e punës e vlefshme si dhe të rezultojë në listë-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit).

c) **1 (një)** person, pjesë e stafit të shoqërisë, të pajisur me certifikatë të Trajnimit për **“Punime në prani/prezence uji”**, e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.  
(Për përgjegjësën e Punimeve në prani uji duhet të paraqitet Certifikata përkatëse si dhe Kontrata e punës e vlefshme si dhe të rezultojë në listë-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit).

ç) **1 (një)** person, pjesë e stafit të shoqërisë, i certifikuar si **“Përgjegjës për mbrojtjen dhe administrimin/menaxhimin e dëmeve në mjedis”**, e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.

(Për ekspertin e Dëmit në Mjedis duhet të paraqitet Certifikata përkatëse si dhe Kontrata e punës e vlefshme si dhe të rezultojë në listë-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit).

d) **1 (një)** person, pjesë e stafit të shoqërisë, të pajisur me certifikatën e Trajnimit për **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Punë”**, **“Përgjegjës për sigurinë”**, e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Gjithashtu kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 **“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”** dhe V.K.M nr. 312, datë 05. 05. 2010 **“Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”**.

Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës.

Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

dh) Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij **1 (një)** person të certifikuar për **“Ndihmën e parë dhe ndërhyrje ndaj emergjencave”**, i cili duhet të figurojë në listë-pagesë minimalisht për 3 (tre) muajt e fundit.

#### **Argumentimi:**

Kërkesa për disponimin e këtyre punonjësve që përmbush kriteret për të qenë **“Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”**, është një kërkesë në përputhje me natyrën e punimeve, dhe vendndodhjes së punimeve, ku njësia e prokurimit vlerëson se, bazuar në ligjin 10 237, dt. 18. 02. 2010 **“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”** dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 312, 05. 05. 2010 **“Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”**, është i nevojshëm disponimi nga operatorët ekonomikë i **punonjësit** të certifikuar si **“Ekspert për Ndihmën e Parë dhe Ndërhyrjen ndaj**

*Emergjencave*”, me qëllim instruktimin e punonjësve dhe dhënien e ndihmës së parë në rast rrezikimi të jetës së punonjësve të angazhuar në kryerjen e punimeve objekt kontrate.

e) Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij **4 (katër)** persona specialistë të certifikuar për **“Punime në lartësi”**, të cilët duhet të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë. Detyrimisht të paraqiten kontratat e punës dhe certifikatat përkatëse të tyre.

ë) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **1 (një) mjek ndërmarrjeje**. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve si vijon:

- Urdhër mjeku,
- Diplomë,
- C.V,
- Librezë pune
- Kontratë Pune të lidhur midis mjekut me operatorin ekonomik, e cila duhet të jetë detyrimisht noteriale dhe e vlefshme për periudhën e ndërtimit.

**Argumentimi:**

Kërkesa e bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në përputhje me parashikimet e VKM nr. 108, datë 9. 2. 2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, sipas të cilave, kompanitë që operojnë në fushën e ndërtimit, mund të sigurojnë shërbimet mjekësore për stafin e tyre, nëpërmjet punësimit të një mjeku, apo nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore me individë apo subjekte që operojnë që në këtë fushë.

**Shënim:** Për piken **2.3.5** me nënpikat, si më sipër, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST.

**Operatori Ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.**

**Argumentimi:**

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për realizimin e kontratës në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ( i ndryshuar), neni 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat punë publike”, pika 6 geramat: c, ç, d, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 77.

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personeli i nevojshëm inxhinierik, referuar zërave të preventivit të objektit për realizimin me sukses të kontratës, AK është mbështetur në Ligjin 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 77 pika 4: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në

*njoftimin e objektit të kontratës.”*

**2.3.6** Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësimin jo më pak se **69 (gjashtëdhjetë e nëntë) punonjës** për periudhën të paktën në **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafit menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës përkatëse në DST, *dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listë-pagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

#### **Argumentimi:**

Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i zbatueshëm sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do të publikohen së bashku me Dokumentet e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri prej jo më pak se 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) punonjës në total (ku janë përfshirë Drejtorët Teknikë, Ing. Mbështetës, punonjësit e specialiteteve të ndryshme për punimet përkatëse, shoferë, manovratorë), është caktuar në bazë të llogaritjeve (zberthimit) të zërave të punës dhe volumit përkatës të çdo zëri në analizat teknike si dhe grafikut në zbatimin të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë për jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e procesverbalit të lirimimit (dorëzimit) të sheshit të ndërtimit. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë afatin e zbatimit në grafikun e punimeve si dhe orët total të punës për secilin zë punimesh në kontratës që prokurohet.

Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të t’i dhënë garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listë-pagesat e punonjësve, mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19 .05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

Nga ky vlerësim është llogaritur që për periudhën e përcaktuar sipas grafikut të punimeve, të kërkuar nga AK për realizimin e punimeve duhen të kryhen nga:

Nga ana teknike argumentojmë se numri prej jo më pak se **69 (gjashtëdhjetë e nëntë) punonjës** në total (ku janë përfshirë Drejtorët Teknikë, Ing. Mbështetës, punonjësit e specialiteteve të ndryshme

për punimet përkatëse, shoferë, manovratorë), është caktuar në bazë të llogaritjeve (zbërthimit) të zërave të punës dhe volumit përkatës të çdo zëri në analizat teknike si dhe grafikut në zbatimin të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë për jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarikë nga data e miratimit të sheshit të ndërtimit. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë afatin e zbatimit në grafikun e punimeve si dhe orët total të punës për secilin zë punimesh në kontratës që prokurohet.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si dhe të përfshirë në listë-pagesa për periudhën 3 muajt e fundit, me profesionet si më poshtë:

<b>Lloji i Specialistit</b>	<b>Numri i kërkuar</b>
Teknik Ndërtimi (me diplomë të mesme profesionale)	2
Gurë punues/Gurë gdhendës	3
Murator / Suvatues	5
Karpentier	3
Hekurkthyes	3
Hidraulik	8
Saldator	3
Hidro-izolues	2
Pllakashtrues	2
Betonues	3
Elektricitist	2
Bojaxhi	2
Mekanik	2
Specialist për konstruksione metalike/montator	2
Specialist ndërtimi	1

Krahas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

<b>Nr.</b>	<b>Emër Mbiemër i punonjësit</b>	<b>Profesioni</b>	<b>Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës</b>	<b>Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)</b>
1.				
2.				
etj.				

\* Disponimi i stafit/punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: Për specialistët e sipërcituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten, dëshmitë/certifikatat ose çdo dokument tjetër që

vërteton diplomimin/trajnimin/ose kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme.

- Kontrata e punës e vlefshme,
- Dëshmi/ certifikatë kualifikimi të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme/ ose të shkollës së lartë,
- Secili specialistë i sipërcituar sipas profesioneve, duhet të figurojë në listë-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa specifike për Stafin e specialistëve është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë, Preventivit të Punimeve, si dhe në përputhje me stafin inxhinierik të kërkuar dhe në bashkëpunim me fuqinë tjetër punëtore, do jenë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin si dhe brenda afatit.

### **Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të projektit të zbatimit punimeve.**

- **Teknik ndërtimi** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin e zbatimit gjithashtu për koordinimin e grupeve të punës.
- **Gurë punues/Gurë gdhendës** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të gurëve në mbrojtjen lumore me gabiona, si pjesë integrale e realizimit të zërave të punimeve ndërtimore.
- **Murator / Suvatues** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të muraturës dhe suvatimeve sipas zërave të punimeve ndërtimore.
- **Karponenteri** është i nevojshëm për përgatitjen e kallëpeve të betonit të depove puseta godinave etj.
- **Hekurkthyesi** është i nevojshëm për prerjen, kthimin dhe vendosjen e hekurit depove puseta godinave etj.
- **Hidrauliku** është i nevojshëm për realizimin e punimeve hidraulike dhe/ose hidrosanitare.
- **Saldatori** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të saldimit në sektorë të ndryshëm si, tuba transmetimi dhe shpërndarje, nyje konstruksione metalike, etj.
- **Hidro-izoluesi** është i nevojshëm për realizimin e punime të hidro-izolimit.
- **Shtruesi i pllakave (Pllakashtruesi)** është i nevojshëm për realizimin e shtresave dhe dyshemeve deri në shtrim dhe veshje.
- **Specialisti i duro/aluminit** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të dyerve, dritareve, vetratave etj. të tipit duralumin sipas
- **Betonuesi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të betonimit në objekt.
- **Elektrici** është i nevojshëm për realizimin e punimeve elektrike.
- **Bojaxhiu** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të lyerjes.
- **Mekaniku** është i nevojshëm për realizimin e punimeve mekanike.
- **Specialist për konstruksione metalike/montator**, është i nevojshëm për zërat e punimeve si në tubacionet, fllanxhat, montim-saldim i saraçineskave, skelave etj.
- **Specialisti i ndërtimit** është i nevojshëm për realizimin e punime të specialiteteve të ndryshme të ndërtimit.

Autoriteti Kontraktor gjykon se pa këta punonjës nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt prokurimi, në kohë dhe cilësi, ku për vërtetimin e disponimit të tyre është kërkuar plotësimi dhe paraqitja e të dhënave sipas tabelës të përcaktuar, dhe paraqitja e dokumentacionit, dëshmitë/

certifikatat e kualifikimit të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, për vërtetimin se këto punonjës janë të kualifikuar për kryerjen e punimeve objekt kontrate, si dhe kanë njohuri për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë në lidhje kryerjen e punimeve, përdorimin e mjeteve, marrjen e masave mbrojtëse etj., **në zbatim të Rregullores së Sigurimit teknik për punën në ndërtim**, si dhe të figurojnë të punësuar në listë-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

**2.3.8** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi **6 (gjashtë)** shoferë të mjeteve të rënda/kamioni dhe **9 (nëntë)** manovratorë (*4 automakinist, 4 fadromistë, si dhe 1 buldozerist*), të cilët duhet të figurojnë në listë-pagesa të punësuar për periudhën 3 (tre) muajt e fundit në rastin kur mjetet/makineritë e deklaruara janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/makineritë disponohen me qira, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,
- Për stafin manovratorë/automakinist të paraqiten: Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor;

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhrin nr. 200, datë 16. 5. 2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Autoriteti Kontraktor e vlerëson të nevojshme që operatori ekonomik duhet të disponojë punonjësit e kualifikuar si më sipër, pasi kjo kërkesë lidhet ngushtësisht me mjetet e kërkuara në pikën 2.3.10, të dokumenteve të tenderit, në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi, ku për drejtimin e mjeteve të vlerësuara të domosdoshme për realizimin e punimeve në fjalë, nevojiten drejtuesit respektivë, të pajisur me dokumentacionin përkatës, në përputhje me Kodin Rrugor dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

**2.3.9** Në përputhje me kërkesat dhe specifikat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe projekt preventiv, për materialet:

- a. Hekur ndërtimor;
- b. Rrjetë/tel i zinguar për rrethime, gabiona etj.;
- c. Hidraulike (tuba, rakorderi ujësjellësi);
- ç. Pompa zhytëse dhe njësi klorinimi;



- d. Bojëra për lyerje;
- dh. Materiale Hidroizolues;
- e. Materiale Elektrike.

#### **Operatori ekonomik duhet të paraqesë:**

- **Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar**, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave objekt i këtij prokurimi.
- **Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve** për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen, të përkthyer në shqip.
- Të gjitha materialet duhet të jenë sipas standardeve Evropiane si dhe të prodhuara nga prodhues të certifikuar / ose të pajisur me Certifikatë konformiteti.

***Për plotësimin e pikës 2.3.9, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në rast se nuk janë vetë prodhues apo furnizues të këtyre mallrave duhet ta dokumentojnë duke paraqitur Autorizimet/Kontratat e furnizimit përkatëse si dhe certifikatat e sipër kërkua për secilin prej mallrave si dhe një vetëdeklarim që është konform sistemeve të menaxhimit të cilësisë.”***

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, paragrafi 1, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Kjo kërkesë është vendosur për të garantuar autoritetin kontraktor se operatori ekonomik i ka kapacitetet për të ofruar furnizim të vazhdueshëm me materialet e nevojshme për kryerjen e punimeve sipas zërave të preventivit.

Paraqitja e këtyre dokumenteve është vlerësuar nga Autoriteti kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standardeve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, certifikatat e mësipërme shërbejnë për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Kjo referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr. 285 datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duhet që këto materiale e pajisje të plotësojnë parametrat dhe standardet e kërkua në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: Autorizim prodhuesi ose distributorin, katalogët ose pjesë të tyre, dëshmitë e testeve të kryera ose ISO, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

Gjithashtu, përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ku duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t’i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, **me qëllim verifikimin/vlerësimin nga A.K, nëse këto materiale/pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet e kërkua në dokumentet e tenderit**, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të certifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standardeve të miratuara.

**2.3.10** Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si me poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit):

<b>Mjetet</b>	<b>Sasia</b>	<b>Gjendja</b>
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 11 (njëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	5 copë	Pronësi ose me qira
Kamion (kapaciteti mbajtës minimumi 5 (pesë) ton dhe maksimumi 10 (dhjetë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qira
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pikë pesë) ton dhe maksimumi 5 (pesë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qira
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5 (një pikë pesë) ton dhe maksimumi 3.5 (tre pikë pesë) ton për secilën kamionçinë	3 copë	Pronësi ose me qira
Kamion (kapaciteti mbajtës mbi 20 (njëzet) ton	3 copë	Pronësi ose me qira
Dumper kantieri	2 copë	Pronësi ose me qira
Fadromë me goma (Mjet teknologjik)	4 copë	Pronësi ose me qira
Ekskavator me goma (Mjet teknologjik)	2 copë	Pronësi ose me qira
Auto betonierë	2 copë	Pronësi ose me qira
Auto-pompë Betoni	1 copë	Pronësi ose me qira
Mini-ekskavator	2 copë	Pronësi ose me qira
Mini-fadromë	2 copë	Pronësi ose me qira
Makineri teknologjike (trancher) për frezim dhe hapje kanali me thellësi mbi 50 cm në rrugë të asfaltuara	1 copë	Pronësi ose me qira
Autovinç	2 copë	Pronësi ose me qira
RTV Rimorkiator ose Karruatrec	2 copë	Pronësi ose me qira
Ekskavator me zinxhirë	2 copë	Pronësi ose me qira
Rul vibrues (ngjeshës)	2 copë	Pronësi ose me qira
Prerëse sharrë Betoni/Asfalti	2 copë	Pronësi ose me qira
Vibrator betoni	3 copë	Pronësi ose me qira
Tokmak me karburant ose elektrik për ngjeshje	1 copë	Pronësi ose me qira
Pllakë vibruese	1 copë	Pronësi ose me qira
Kompresor	1 copë	Pronësi ose me qira
Helikopter për luçidim, nivelues	1 copë	Pronësi ose me qira
Depozita uji me kapacitet min. 2000 litra	2 copë	Pronësi ose me qira
Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qira
Kontenier Stacioner (zyre në objekt)	1 copë	Pronësi ose me qira
Prozhektorë kantieri	2 copë	Pronësi ose me qira
Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qira
Pompë suvatimi	1 copë	Pronësi ose me qira
GPS për rlevime matje/azhornime topografike	1 copë	Pronësi ose me qira
Total Station për rlevime matje/azhornime topografike	1 copë	Pronësi ose me qira

Sondë shpimi “UKS” ose ekuivalente $\phi$ 1 m, me thellësi shpimi mbi 35 m/l	1 copë	Pronësi ose me qira
Sistem Well Point (ose ekuivalent)	1 copë	Pronësi ose me qira
Aparaturë për bashkim/ngjitje tubacionesh me metodën “Elektro Fusion”	2 copë	Pronësi ose me qira
Aparaturë për bashkim/ngjitje tubacionesh me metodën “Kokë më kokë”	2 copë	Pronësi ose me qira
Motosaldatriçe	1 copë	Pronësi ose me qira
Elektrosaldatriçe	2 copë	Pronësi ose me qira
Pajisje elektronike për matjen e presionit të ujit /ekuivalent Barometër	1 copë	Pronësi ose me qira
Pajisje e lëvizshme me ultratinguj për matjen e rrjedhjes / prurjes (Pajisja dixhitale) /ekuivalent Flowmeter	1 copë	Pronësi ose me qira
Fabrikë Betoni, pajisur me leje mjedisore nga QKL	1 copë	Pronësi ose me qira ose me kontratë/marrëveshje furnizimi/bashkëpunimi
Nyje Inertesh, pajisur me leje mjedisore nga QKL	1 copë	Pronësi ose me qira ose me kontratë/marrëveshje furnizimi/bashkëpunimi

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 4 (katër) copë
- Fikse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 (pesë) copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 (pesë) copë
- Uniforma/Jelek pune 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 (pesëmbëdhjetë) copë

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr. 8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- a) *Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme).*
- b) *Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash (e vlefshme).*
- c) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo dokument që vërteton marrjen me qira.*
- ç) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- d) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas Deklaratës se shoqërisë ofertuese.*

dh) Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi /qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe volumeve të punës në projekt, duke iu referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekteve. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës.

**Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetet:** "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, në nenin 92 parashikon shprehimisht se: "Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor".

-"Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 79/3 parashikon shprehimisht se "Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë janë të detyruara të kalojnë në kontroll teknik..."

-Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" neni 4 parashikon shprehimisht se: "Pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim..."

-Ligji nr.8308 datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore" neni 5 parashikon shprehimisht se: "Veprimtaria e transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra për të tretë dhe me qira, kryhet mbi bazën e licencës..."Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.

**2.3.11** Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- Certifikatat e cilësisë sipas Standardit **ISO 9001:2015** (për sistemin e menaxhimit të cilësisë) (ose ekuivalente), e vlefshme.
- Certifikatat e cilësisë sipas Standardit **ISO 14001:2015** (për sistemin e menaxhimit të mjedisit) (ose ekuivalente), e vlefshme.

- Certifikatat e cilësisë sipas Standardit **ISO 45001-2018** (për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë), ose ekuivalente, e vlefshme.
- Certifikatat e cilësisë sipas Standardit **BS ISO 39001:2012** (për sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor) (ose ekuivalente) e vlefshme.
- Certifikatat e cilësisë sipas Standardit **ISO 50001:2018** (për sistemin e menaxhimit të energjisë) (ose ekuivalente), e vlefshme.
- Certifikatat e cilësisë sipas Standardit **UNI EN ISO 3834 -2:2006** (për kërkesat e cilësisë për saldimin e materialeve metalike) (ose ekuivalente), e vlefshme.
- Certifikatat e cilësisë sipas Standardit **ISO 1452-1:2009** (për sistemin e tubacioneve plastike për furnizim me ujë, kullimet dhe kanalizimet nëntokësore dhe mbitokësore) (ose ekuivalente), e vlefshme.

*Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, ISO-t duhen plotësuar nga secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë.*

*Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit.*

#### **Argumentimi:**

Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë standardet e menaxhimit të mjedisit. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të Ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standardet e kërkuara të cilësisë dhe standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standardet e menaxhimit të mjedisit.

Është e nevojshme pasi një seri normash dhe standardizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standardet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikatat ISO të mësipërme me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulëta.

**2.3.12 a)** Operatori Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga QKB me **Kodin III.2.B** “Grumbullim dhe Transport i Mbetjeve të Ngurta” - Veprimtaritë e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis-Shërbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis.

b) Operatori Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga QKB me Kodin **III.7.B** “Shpues profesionist për ujë” - Veprimtaritë e Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë.

*Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, ISO-t duhen plotësuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë.*

*Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të*

konformitetit.

**Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të Ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Po ashtu, referuar preventivit të punimeve, duke qenë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (*dheu, kanale*), prishje struktura dhe shtresa rrugore, dhe kryerjen e transportit të tyre në vend-depozitim, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të Ligjit nr. 10 463, datë 22. 09. 2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 575, datë 24. 06. 2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” **ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, ndaj operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B)** sipas Ligjit nr. 10 081, datë 23. 02. 2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto licenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr. 538, datë 26. 05. 2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

**1.3.13** Operatori/ët ekonomikë duhet të dorëzojnë *Grafikun e punimeve në përputhje me zërat e punës*, që duhet të jetë në përputhje me afatin (sipas tabelës në Shtojcën nr. 6, (sipas preventivimit të hartuar).

**Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të Ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 39, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu në nenin **15 pika 3/a** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19. 05. 2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku ndër të tjera parashikohet se: **“a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;”**

**2.3.14** Operatori/ët ekonomikë duhet të kenë kontratë noteriale më një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standardeve SSH EN SSH EN 12350-2:2019, SSH EN 12504-2:2021, SSH EN ISO 6892 – 1:2019, SSH EN 12390-8:2019 (ose ekuivalente).

**Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të Ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

**2.3.15** Çdo ofertues duhet të paraqesë Plan-organizimin dhe Planin e Sigurisë në Kantier për punimet në objekt sipas VKM nr. 692 datë 13. 12. 2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe të ruajtjes së shëndetit në punë” i ndryshuar.

**Argumentimi:**

Kjo kërkesë është mbështetur në Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 46/1/b, i cili përcakton *se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm, të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të*

*tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.*

Plan organizimi i punimeve në objekt krijon bindjen se pasqyrohet në mënyrë të qartë një tabelë e detajuar i punimeve të punimeve në të cilën të identifikohen zërat e punimeve, radha e tyre, kohëzgjatja e punimeve referuar datës së fillimit dhe datës së mbarimit të tyre sipas grafikut të institucionit i cili e ka të domosdoshme ta përfundojë jo më vonë se afati i përcaktuar gjithë rikonstruksionin, me synimin për të përmbushur objektivat dhe për vënien në jetë të objektit të kontratës.

**2.3.16** Operatori/ët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin deklaratën ku shprehen se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s'kualifikim.**

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

### **Komisioni i Prokurimit**